Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejta ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit!

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 10

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, seicili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht¹;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojcës 6;Nuk eshte e zbatueshme .

b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;

c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;

ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 11/1

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2016-2018) duhet të mos jetë më e vogël se 4,000,000 (Katër milion) Lekë. *Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ose kopje të bilanceve të 3 tre viteve të fundit (2016-2018).*

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit, shërbime të mëparshme, të ngjashme, me një vlerë jo më të vogël se 4,000,000 (Katër milion) Lekë.

Për të provuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Për shërbime të ngjashme ndaj organeve publike: Vërtetime të lëshuara nga enti publik për realizimin me sukses të kontratës dhe fatura tatimore shitje ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Për shërbime të ngjashme ndaj privateve duhet të paraqesë: Fatura tatimore shitjesh ku të jenë të përcaktuara qarte palet, datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e shërbimit duhet të paraqesë stafin e kualifikuar si më poshtë:

- 1) Kryetar grupi, diplomë master në shkencë sociale, politike ose Ekonomi biznes, me eksperiencë në zhvillim socio-ekonomik, të jete autor (në grup apo individualisht), i minimalisht 2 strategjive kombëtare/ lokale ose planeve për përgjegjshmërinë sociale korporatave, si dhe të ketë punuar së paku 5 vite si Menaxher Projekti në projekte të ngjashme me këtë Konsulencë.
- 2) Ekspert Turizmi, diplomuar në shkencat ekonomike ose sociale ose Master në menaxhim turizmi, me eksperiencë në menaxhim ose në industrinë e turizmit. Të ketë patur eksperiencë të ngjashme në hartimin e raporteve mbi propozimin dhe produktin turistik në nivel lokal ose kombëtar.
- 3) Ekspert i Qeverisjes Vendore, diplomë master në shkencë sociale, politike, Ekonomi ose inxhinieri, me eksperiencë profesionale me institucionet e pushtetit lokal. Njohje e thelluar e problemeve të zhvillimit ekonomik lokal dhe e politikë-bërjes në nivel lokal.
- 4) Ekspert i Bujqësisë, diplomë master në Agronomi, Hortikulturë ose fusha të tjera të ngjashme, me eksperiencë profesionale në fushën e prodhimit bujqësor. Njohje me problemet e zhvillimit të bujqësisë dhe me projekte të zhvillimit rural në përgjithësi.
- 5) Ekspert Social, diplomë master në Shkencë Sociale, me eksperiencë në hartimin e vlerësimeve/raporteve të botuara, në lidhje me çështje sociale në projekte të ngjashme.
- 6) Ekspert Mjedisor, diplomuar në Inxhinieri Mjedisi apo në fushën e çështjeve mjedisore, me eksperiencë në çështje mjedisore vecanërisht në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe auditim mjedisor - VNM, preferohet Master në shkencat mjedisore.
- 7) Specialist GIS/Planifikues Urban, diplomuar në Gjeodezi, Arkitekture ose Gjeoinformatike, të jete i pajisur me Certifikatë në aplikimet GIS, si dhe të ketë Përvojë në përdorimin e programit GIS (Geographical Information System).

- 8) Ekspert i Energjisë, diplomë master në fushën e inxhinierisë, me përvojë në fushat e burimeve gjeneruese , njohje të sektorit të energjisë elektrike dhe të aktorëve kryesorë të fushës.
- 9) Koordinatorë lokalë (3 – 1 në cdo bashki kryesore), me arsim të lartë, dhe Përvojë në projekte të mërpashme me bashkitë e zonës.

Për stafin e mësipërm operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Diplomë universitare, Master, Certifikatë kualifikimi, CV.

Eksperiencat /Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar, do të vlerësohen me pikë si nënkriter për në fazën e dytë të procedurës.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë CV-në e kompanisë.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

• Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

• Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

• Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

• Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

• Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 11/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në

mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

- 1) Shërbimi që kërkohet: "Përpilimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës (PSK) për KESH sh.a" .**
- 2) Afatet e ekzekutimit: 25 (njëzet e pesë) javë.**

TERMAT E REFERENCËS

1. PËRSHKRIMI I DETYRËS

1.1. Konteksti

Me rritjen dhe evoluimin e pritshmërisë dhe vetëdijes së komuniteteve lokale pritëse apo konsumatorit fundor mbi detyrimet dhe përgjegjësitë sociale të institucioneve, organizatave dhe bizneseve në lidhje me aktivitetet e tyre, lind nevoja e hartimit të një strategjie të përgjegjshmërisë sociale të korporatës (PSK).

Në nivel ndërkombëtar, mund të evidentohet, se Evropa ka kulturën më të fortë të PSK në botë, që është reflektuar në faktin se Komisioni Evropian (KE) kohët e fundit ka kërkuar të zyrtarizojë konceptin dhe promovimin e një vizioni të përbashkët të PSK për të gjithë vendet anëtare dhe ato në proces anëtarësimi. Qasja në furnizim me energji me cilësi të lartë, të rinovueshme, të besueshëm, me çmime më të ulta, dhe me më shumë efikasitet, është parë si një domosdoshmëri në ekonomitë në zhvillim apo të zhvilluara në Europë.

Për të patur një dokument sa më gjithëpërfshirës të PSK, treguesit duhet të grupohen dhe përfaqësojnë të paktën tre shtyllat kryesore të ndërhyrjes, si komponentin social, komponentin mjedisor dhe komponentin ekonomik, si dhe fokusimin dhe ndërthurjen e këtyre komponentëve me njëri-tjetrin, duke përfshirë fusha si arsimiti, infrastruktura, shërbimet, inovacionet, etj.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (**KESH**) është **prodhuesi më i madh i energjisë elektrike** në Shqipëri dhe më i madhi në rajon për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (uji).

KESH është përgjegjës për administrimin e 3 (tre) njësisve prodhuese në kaskadën mbi lumin Drin (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) me një fuqi të instaluar prej 1,350 MW.

KESH është mbajtës i licencës së (i) prodhimit të energjisë elektrike, (ii) tregtimit të energjisë elektrike, dhe (iii) furnizimit me energji elektrike¹.

Si pjesë e përpjekjeve për t'i shërbyer sa më mirë konsumatorëve dhe komunitetit të prekur nga projektet që zhvillon apo asetet që disponon, KESH gjykon të rëndësishme hartimin dhe zbatimin e një strategjie për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës (PSK). PSK është një koncept i njohur botërisht në lidhje me sjelljen e përgjegjshme të një korporate, detyrimet morale dhe etike në lidhje me të gjitha fushat që ndikohen prej saj, si punonjësit, komuniteti, mjedisin, konkurrencën, ekonominë dhe të gjitha fushat që ndikohen prej saj.

Këshilli i Biznesit Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, ka dalë në konkluzionin se një strategji koherente e PSK bazuar në integritet, vlerat e shëndosha dhe një qasje afatgjatë ofron përfitime të qarta për kompanitë dhe kontribuon në mirëqenien e shoqërisë.

Përpara këtyre fakteve, si edhe përpara objektivave afatgjatë të KESH për të kontribuar pozitivisht në komunitetet ku operon, korporata si hap të parë drejt arritjes së këtij qëllimi,

gjykon përpilimin e një strategjie për PSK të shoqëruar me një plan-veprimi për zbatimin e saj. Me anë të kësaj konsulence, KESH sh.a. synon përpilimin e një dokumenti cilësor dhe planifikues për garantimin në mënyrë të vazhdueshme e të qëndrueshme të një impakti pozitiv multidimensional në komunitetet ku operon.

1.2. Objektivi

Qëllimi i kësaj konsulence është të ndihmojë KESH sh.a. në krijimin e një strategjie të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës. Strategjia do të synojë integrimin e komponentëve sociale e mjedisore, si dhe ndërveprimin me aktorët gjatë kryerjes së aktivitetit, duke arritur një ekuilibër të nismave ekonomike, mjedisore e sociale.

Kryesisht synimi është gjithashtu që KESH të luajë një rol më aktiv në angazhimin e aktorëve lokal kombëtar apo lokal në politikat dhe objektivat e saj të zhvillimit.

2. DETYRA SPECIFIKE DHE PRODUKTE

Më specifikisht, konsulenca do të synojë të kryejë:

1. Vlerësimin e situatës aktuale në zonën e interesit (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës) dhe i performancës së deritanishme të KESH në lidhje me komponentët sociale e mjedisore (aktivitetet, shërbimet, hapat e ndërmarrë, etj.).

Produkti: Raport mbi gjendjen bazë të aktiviteteve të kryera në kuadër të Strategjisë për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës.

2. Përpilimin e Strategjisë për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës, përfshirë Planin e Angazhimit të Aktorëve dhe Planin e Zbatimit të Strategjisë si pjesë e saj.

Produkti: Strategjia e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës, sipas përcaktimeve në pikën 2.1.2.

3. Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës

Vlerësimi duhet të identifikojë mungesat, boshllëqet, si dhe të rekomandojë mundësitë që korporata të arrijë të maksimizojë impaktin pozitiv, multidimensional të saj.

Produkti: Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë Sociale të Korporatës

2.1. PERSHKRIM I DETAJUAR I DETYRAVE

2.1.1. Raport mbi gjendjen bazë të përgjegjshmërisë sociale të korporatës:

Aktivitetet që pritet të organizohen në këtë fazë janë:

- Kick-off; takim koordinues dhe shtjellues me ekipin e KESH qendër dhe me njësitë prodhuese me qëllim hartimin e një plani pune.
- Mbledhja e materialeve të nevojshme për hartimin e raportit mbi gjendjen bazë
- Takime pune me përfaqësues të Bashkive, pushtetin lokal, NGO aktive në zonë, etj.
- Dorëzim i Raportit Vlerësues të Situatës Aktuale, së bashku me minutat e takimeve.

Vlerësimi duhet të përfshijë, por jo të jetë i kufizuar tek:

- Gjendja ekzistuese bazë, vlerat e korporatës, misioni dhe iniciativat ekzistuese në lidhje me Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës;
- Karakteristikat sociale, mjedisore dhe ekonomike të zonave të veprimtarisë/zonës së interesit;
- Nismat e ndërmarra nga KESH sh.a. në funksion të aktiviteteteve të përgjegjshmërisë sociale dhe mjedisore si dhe impakti i tyre në komunitetet pritëse.
- Nismat sociale e mjedisore të ndërmarra në zonë nga entitete të tjera me misione të ngjashme.

Identifikim i sfidave dhe potencialit të zonave të interesit, specifikisht territoret e Bashkive të Vaut të Dejës, Kukësit dhe Tropojës. ¹ Hartëzim i zonës dhe i grupeve kryesore të interesit në nivel vendor e qendror me të cilët KESH ka/duhet të ketë marrëdhënie të vazhdueshme. Identifikimi dhe hartëzimi i Aktorëve lokalë dhe kombëtarë të cilët janë të prekur apo kontribues në projektet e zhvillimit ose operimit nga ana e KESH.

Kërkesat e legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, parimin “ndotësi paguan”, opsionet në lidhje me qasjet potenciale nga ana e KESH sh.a. për përmirësimin e komponentit mjedisor.

2.1.2. Përpilimi i Strategjisë për PSK

Strategjia për PSK do të komunikohet në të gjithë korporatën. Strategjia duhet të prioritetizojë sfidat zhvillimore të zonave të interesit duke respektuar kuadrin ligjor përkatës, si dhe duke marrë në konsideratë konventat dhe standardet ndërkombëtare.

Aktivitetet që pritet të kryhen në këtë fazë janë:

- Organizim takimesh me grupet e interesit (organizim takimesh dhe minimalisht organizimi i 1 (një) workshop-i në territorin e secilës bashki të prekur - Vaut të Dejës, Kukësit dhe Tropojës) me qëllim identifikimin e nevojave dhe potencialeve kryesore të zonave dhe potencialit të saj; hartëzim i nevojave kryesore të zonës për zhvillim ekonomik
- Dorëzim i Strategjisë për PSK, përfshirë planin e angazhimit të aktorëve e grupeve të interesit, të përditësuar
- Prezantim i Strategjisë për PSK me personat përgjegjës dhe drejtues në KESH, feedback.

Strategjia duhet të përmbajë elementet e mëposhtme, por jo vetëm:

- Analiza e çështjeve sociale, oportuniteteve dhe potencialeve të mjedisit rrethues
- Analizë e burimeve dhe kapaciteteve financiare të kompanisë për të mbështetur pergjegjshmerine sociale
- Analizë e potencialeve kryesore të zonave të përcaktuara si zona interesi me qëllim përpilimin e aktiviteteve që KESH mund të ndër marrë për të ndihmuar komunitetet në arritjen e potencialit.
- Analizë dhe përcaktimi i një politike aktive komunikimi dhe konsultimi nga ana e KESH me komunitetet lokale të prekura nga projektet e saj.
- Identifikim i nevojave sociale dhe ekonomike të zonës së synuar
- Përcaktimi i aktiviteve dhe kostoja financiare ose jo-financiare për zbatimin e tyre
- Përcaktimi i një platforme dhe mekanizmi monitorues dhe llogaridhënës
- Plani i përfshirjes së grupeve të interesit, i përditësuar – (Stakeholders engagement plan), hartëzimi i aktorëve kryesorë në zonë dhe identifikimi i mundësive të bashkëpunimit, sipas formatit të hartuar nga KESH sh.a.
- Natyra e veprimtarive që duhet të ndërmerren nga KESH sh.a. në nivelet e mëposhtme:
 - o Menaxhimi i brendshëm (zbatimi i kriterëve ligjore e ekonomike, mekanizmi i ankimit-kujdesi ndaj punonjësve)
 - o Menaxhimi i aktiviteteve me bashkëpunëtorët dhe partnerët (kriteret mjedisore, standardet e punës, furnizuesit kryesorë, etj)
 - o Menaxhimi dhe ndërveprimi me aktorë të jashtëm (kontribute, sponsorizime, aktivitete sociale/vullnetarë, media)

2.1.3. Raporti i planit të veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë

- Përpilimi i profilit të nevojshëm të ekipit brenda KESH që do të sigurojë përmbushjen e këtyre angazhimeve.
- Listë e aktiviteteve dhe afatet kohore për zbatimin e tyre
- Resurset e nevojshme financiare ose jo-financiare.

- Përcaktimi i afateve të zbatimit në nivel komponenti apo aktiviteti.
- Dorëzim i planit të zbatimit për strategjinë, i dakortësuar

PRODUKTET DHE KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e konsulences pritet të jetë 25 javë.

Nr	Produkti/shërbimi	Formati	Kohëzgjatja e detyrës dhe afatet
Vlerësim i gjendjes baze të përgjegjshmerise sociale korporative			
1	Raport mbi analizen e gjendjes baze të përgjegjshmerise sociale korporative, sipas pershkrimit në seksionin 2.1.1:	Katër (4) raporte të printuara në format A4 Kopje elektronike të raporteve në .doc dhe .pdf	6 javë nga firmosja e kontratës. Brenda 4 javeve nga firmosja e kontratës dorëzohet raporti draft Rishikimi nga ana e KESH sh.a. kryhet brenda 1 jave nga dorëzimi i raportit draft Dorëzimi i raportit final, përfshirë komentet dhe sugjerimet e KESH sh.a., kryhet brenda 1 jave nga marrja e rishikimit nga ana e KESH sh.a.
	Strategjia e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës	Katër (4) Raporte të printuara dhe anekset përkatëse në A4. Version elektronik i raporteve në format .doc dhe .pdf.	16 javë nga firmosja e kontratës. Brenda 11 javësh nga firmosja e kontratës) dorëzohet raporti draft Rishikimi nga ana e KESH sh.a. kryhet brenda 2 javësh nga dorëzimi i raportit draft të strategjise Dorëzimi i raportit final të strategjisë, përfshirë komentet dhe sugjerimet e KESH sh.a., kryhet brenda 3 javësh nga marrja e rishikimit nga ana e KESH sh.a.
	Raporti i planit të veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë sociale të korporatës	Katër (4) Raporte të printuara dhe anekset përkatëse në A4. Version elektronik i raporteve në format .doc dhe .pdf.	25 javë nga firmosja e kontratës. 20 javë nga nënshkrimi i kontratës dorëzohet plani draft Rishikimi nga ana e KESH sh.a. kryhet brenda 2 javësh nga dorëzimi i planeve draft Dorëzimi i planeve finale, përfshirë komentet dhe sugjerimet e KESH sh.a., kryhet brenda 3 javësh nga marrja e rishikimit nga ana e KESH sh.a.

EKSPERTIZAT E KËRKUARA

No	Pozicioni	Kualifikime	Eksperiencë (min)
1	Kryetari i grupit	Diplomë Master në shkencat sociale, politike ose Ekonomi, biznes	Ai/ajo duhet të ketë punuar së paku 5 vite si Menaxher Projekti në projekte të ngjashme me këtë Konsulencë. Të jete autor (në grup apo individualisht), i minimalisht 2 strategjive kombëtare apo lokale apo planeve për përgjegjshmërinë sociale korporatave. Të paktën 10 vite eksperiencë në zhvillim socio-ekonomik
2	Ekspert Turizmi	Diplomë në shkencat ekonomike ose sociale ose Master në menaxhim turizmi;	7 vite eksperiencë në menaxhim ose në industrinë e turizmit. Të ketë patur eksperiencë të ngjashme në hartimin e raporteve mbi propovimin dhe produktin turistik në nivel lokal ose kombëtar.
3	Ekspert i Qeverisjes Vendore	Diplomë Master në shkencat sociale, politike, Ekonomi ose inxhinieri	7 vite eksperiencë profesionale me institucionet e pushtetit lokal. Njohje e thelluar e problemeve të zhvillimit ekonomik lokal dhe e politikë-bërjes në nivel lokal.
4	Ekspert i Bujqësisë	Diplomë Master në Agronomi, Hortikulturë ose fusha të tjera të ngjashme	7 vite eksperiencë profesionale në fushën e prodhimit bujqësor. Njohje me problemet e zhvillimit të bujqësisë dhe me projekte të zhvillimit rural në përgjithësi.
5	Ekspert Social	Diplomë Master në Shkencat Sociale;	7 vite eksperiencë në hartimin e vlerësimeve/raporteve të botuara, në lidhje me çështje sociale në projekte të ngjashme.
6	Ekspert Mjedisor	Inxhinier Mjedisor apo diplomë në fushën e çështjeve mjedisore;	7 vite eksperiencë në çështje mjedisore vecanërisht në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe auditim mjedisor - VNM, Preferohet Master në shkencat mjedisore.
7	Specialist GIS/Planifikues Urban	Diplomë në Gjeodezi, Arkitekture ose Gjeoinformatike. Certifikatë në aplikimet GIS	Përvojë në përdorimin e programit GIS (Geographical Information System).
8	Ekspert i Energjisë	Diplomë master në fushën e inxhinierisë	Përvojë në fushat e burimeve gjeneruese ; njohje të sektorit të energjisë elektrike dhe të aktorëve kryesorë të fushës.

	Koordinatorë lokale (3 – 1 në cdo bashki kryesore)	Diplomë të shkollës së lartë	Përvojë në projekte të mërpashme me bashkitë e zonës.
--	--	---------------------------------	--

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

–

–

–

–

–

–

–

–

–

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 17

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
----------	-------

Dokumentat standarte të tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Dokumentat standarte të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 19

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

Dokumentat standarte të tenderit

- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
